



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:122136

Datë: 23.04.2024

Numri i dokumentit: 05606473

KPPP.nr.1456/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Luani Consulting” SH.P.K., me NUI:810867228, me seli në Prishtinë, Rruga B, Mati 1, nr.38-1, kundër debitorit “SHEHU- OIL” SH.P.K., me NUI:810172651, me seli në Rahovec Rr.“Xhelal Hajda”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Florid Hasku, avokat nga Rahoveci, Rr.”Dëshmorët e Pashtrikut” pn., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.507/21 të datës 29.04.2021, të Përmbartuesit Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 23.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “SHEHU- OIL” SH.P.K., me NUI:810172651 dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.507/21 i datës 29.04.2021, i Përmbartuesit Privat Eset Murati për pjesën e detyrimit në shumën prej 450.00 € (katërqind e pesëdhjetë euro).
- II. REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit “SHEHU- OIL” SH.P.K., me NUI:810172651 pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.507/21 të datës 29.04.2021, të Përmbartuesit Privat Eset Murati sa i përket shumës prej 20,268.80 € (njëzetmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë euro).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “Luani Consulting” SH.P.K., me NUI:810867228, ndaj debitorit “SHEHU- OIL” SH.P.K., me NUI:810172651, sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.507/21 të datës 29.04.2021, për shumën prej 450.00 € (katërqind e pesëdhjetë euro).

- IV. MBETET në fuqi Urdhri Përmbarrimor P.nr.507/21 të datës 29.04.2021, i Përmbarruesit Privat Eset Murati sa i përket shumës prej 20,268.80 € (njëzetmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë euro).
- V. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 20,268.80 € (njëzetmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë euro).
- VI. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Luani Consulting” SH.P.K., me NUI:810867228, me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin përmbarrimor P.nr.507/21 të datës 29.04.2021, duke lejuar përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm – fatura me numër FSS-20-000099 e datës 30.04.2020; fatura me numër FSS-20-000102 e datës 01.05.2020; fatura me numër FSS-20-000131 e datës 29.05.2020; fatura me numër FSS-20-000132 e datës 29.05.2020, fatura nr. FSS-20-000164 e datës 30.06.2020; fatura me numër FSS-20-000166 e datës 01.07.2020; fatura me numër FSS-20-000170 e datës 04.07.2020; fatura me numër FSS-20-000171 e datës 07.07.2020; fatura me numër fatura me numër FSS-20-000181 e datës 14.07.2020; fatura me numër FSS-20-000182 e datës 14.07.2020; fatura me numër FSS-20-000185 e datës 16.07.2020; fatura me numër FSS-20-000186 e datës 16.07.2020; fatura me numër FSS-20-000217 e datës 15.08.2020; fatura me numër FSS-20-000221 e datës 19.08.2020; fatura me numër FSS-20-000222 e datës 19.08.2020; fatura me numër FSS-20-000223 e datës 21.08.2020; fatura me numër FSS-20-000224 e datës 21.08.2020; fatura me numër FSM-20-000028 e datës 21.08.2020; fatura me numër FSM-20-000035 e datës 25.08.2020; fatura me numër FSS-20-000227 e datës 26.08.2020; fatura me numër FSS-20-0000228 e datës 26.08.2020; fatura me numër FSS-20-000229 e datës 27.08.2020; fatura me numër FSS-20-000231 e datës 28.08.2020; fatura me numër FSS-20-000234 e datës 31.08.2020; fatura me numër FSS-20-000246 e datës 04.09.2020; fatura me numër FSS-20-000247 e datës 05.09.2020;

fatura me numër FSS-20-000249 e datës 07.09.2020; fatura me numër FSS-20-000250 e datës 07.09.2020; fatura me numër FSS-20-000274 e datës 24.09.2020; fatura me numër FSS-20-000278 e datës 28.09.2020; fatura me numër F55-20-000278 e datës 28.09.2020 dhe fatura me numër FSS-21-000015 e datës 26.01.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 20,718.80 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përbarimit me dhunë, nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, përbaruesi privat zbaton përbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se asnjë dokument i bashkangjitur nuk janë të vërtetuara me vulën e saktësisë së origjinalit andaj propozimi është me të meta ligjore dhe i njëjti nuk i përmbush elementet e domosdoshme, dhe se ky propozim i kreditorit është i para afatshëm. Ka shtuar se me faturat e bashkangjitura prapësimi paraqet fakte me të cilat dëshmon fakte se ai po i përmbahet pagesave dhe obligimeve ndaj kreditorit. Tutje ka theksuar se urdhri për përbarim përmban shkelje esenciale, përkatësisht përmban të meta të tilla ku nuk janë caktuar kreditori dhe debitori i përbarimit. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të shfuqizoj urdhrin për lejimin e përbarimit, të pezullohen të gjitha veprimet, dhe t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, ndër të tjerash ka theksuar se në shkresat e lëndës gjinden faturat në origjinal të nënshkruara nga debitori, afati i pagesës është i shkruar në fatura dhe i njëjti nuk është respektuar. Ka shtuar se sa i përket pagesës në lartësi prej 3,750.00 euro është bërë mbi bazën e profaturës e cila nuk është përfshirë në propozim, kurse fatura me numër FSS-20-000131 e datës 29.05.2020 është paguar andaj i ka propozuar gjykatës që pjesërisht të shfuqizoj urdhrin për përbarim sa i përket faturës së lartcekur, ndërsa sa i përket pjesës tjetër urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën

Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbartimor P.nr.507/21 i datës 29.04.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës me numër FSS-20-000131 e datës 29.05.2020. Gjykata erdhi në këtë përfundim, pasi që në bazë të fletëpagesës së datës 03.06.2020, vërtetohet se debitori ka përmbushur pjesërisht detyrimin dhe atë në shumën prej 450.00 €.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm – fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor, e ka humbur pjesërisht efektin, sepse e njëjta është përmbushur nga ana e debitorit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin P.nr.507/2021 të datës 29.04.2021, për shumën në vlerë prej 20,268.80 €, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.* Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht – fatura me numër FSS-20-000099 e datës

30.04.2020; fatura me numër FSS-20-000102 e datës 01.05.2020; fatura me numër FSS-20-000132 e datës 29.05.2020, fatura nr. FSS-20-000164 e datës 30.06.2020; fatura me numër FSS-20-000166 e datës 01.07.2020; fatura me numër FSS-20-000170 e datës 04.07.2020; fatura me numër FSS-20-000171 e datës 07.07.2020; fatura me numër fatura me numër FSS-20-000181 e datës 14.07.2020; fatura me numër FSS-20-000182 e datës 14.07.2020; fatura me numër FSS-20-000185 e datës 16.07.2020; fatura me numër FSS-20-000186 e datës 16.07.2020; fatura me numër FSS-20-000217 e datës 15.08.2020; fatura me numër FSS-20-000221 e datës 19.08.2020; fatura me numër FSS-20-000222 e datës 19.08.2020; fatura me numër FSS-20-000223 e datës 21.08.2020; fatura me numër FSS-20-000224 e datës 21.08.2020; fatura me numër FSM-20-000028 e datës 21.08.2020; fatura me numër FSM-20-000035 e datës 25.08.2020; fatura me numër FSS-20-000227 e datës 26.08.2020; fatura me numër FSS-20-0000228 e datës 26.08.2020; fatura me numër FSS-20-000229 e datës 27.08.2020; fatura me numër FSS-20-000231 e datës 28.08.2020; fatura me numër FSS-20-000234 e datës 31.08.2020; fatura me numër FSS-20-000246 e datës 04.09.2020; fatura me numër FSS-20-000247 e datës 05.09.2020; fatura me numër FSS-20-000249 e datës 07.09.2020; fatura me numër FSS-20-000250 e datës 07.09.2020; fatura me numër FSS-20-000274 e datës 24.09.2020; fatura me numër FSS-20-000278 e datës 28.09.2020; fatura me numër F55-20-000278 e datës 28.09.2020 dhe fatura me numër FSS-21-000015 e datës 26.01.2021, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në origjinale nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi dhe vula e debitorit si dhe fakti që faturat asnjëherë nuk janë kontestuar nga debitori.

Ndërsa sa i përket dëshmive të paraqitura në prapësimin e debitorit, se lidhur me çështjen konkrete janë bërë pagesa për borxhin e kërkuar sipas faturave të kreditorit, gjykata të njëjtat i shqyrtoi mirëpo në të njëjtat pagesa nuk është specifikuar numri i faturës për të cilën është

përmbushur obligimi, ndërsa debitori nuk ka ofruar asnjë provë përmes të cilave do të mund të vërtetohej fakti se për faturat për të cilat është iniciuar kjo procedurë përmbartimore e ka përmbushur detyrimin e tij.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësime tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendime mund të realizohen në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohej vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit.

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t’ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1456/22, datë 23.04.2024

Gjyqtari

Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.